



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 17.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 14.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Beni Com&SHPK Linda&Infrastruktura" për aktivitetin : "**Ndertimi i Parkut rekreativo-sportiv ne Dardani dhe renovimi i hapesires**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7632-511 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "Beni Com&SHPK Linda&Infrastruktura" e datës 14.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Ndertimi i Parkut rekreativo-sportiv ne Dardani dhe renovimi i hapesires** ", me Nr.616 19 7632 511 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së , të datës 13 .08.2020 të publikuar në Platformën e KRPP-se-E Prokurimi.
2. AK-ja vazhdon aktivitetin sipas Njoftimi i Vendimit i publikuar me datë: 13.08.2020;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Beni Com&SHPK Linda&Infrastruktura" me datë 14.08.2020 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ndertimi i Parkut rekreativo-sportiv ne Dardani dhe renovimi i hapesires**". Autoriteti Kontraktues, me datë 01.08.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Pretendimi se grupi i Oe-ik "Beni Com&Linda" i plotëson kërkesën e FDT është i pabazuar pasi qe kërkesa e FDT-se është si vijon: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapsirave tjera publike, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 800.000,00 euro. Lidhur me këtë ju sqarojme

se asnje komision paraprak nuk ka gjetur se ju e plotesoni kete kriter dhe ato deshmi qe ju pretendoni jane te njejtat qe jane konsideruar ne çdo rast te pa pranueshme;

-Ju e dini se arsyeja kryesore e refuzimit te tenderit tuaj ne kete rast eshte opinioni i AKK-se sipas te cilit eshte konstatuar se ne kompanine tuaj ka konflikt interesi per kete projekt dhe nese mendoni se duhet te kontestohet Opinioni i Agjencise kunder korupcionit,atehere duhet ti drejtoheni te njejtit,pasi qe ai Organ eshte meritor per te konstatuar konfliktin e interesit dhe Autoriteti Kontraktues e ka te detyrueshme ta respektoj.Lidhur me kete edhe ne Vendimet tona paraprake eshte dokumentuar dhe te njejtën gje ka bere edhe AKK-ja qe ka konstatuar se te tenderuesi tjeter nuk ka konflikt interesi,pasiqe anetari i stafit per hartim te projektit,Naser Surdulli,nuk ka qene i punesuar te OE-ik "Rexha" ne kohen kur eshte hartuar projekti,respektivisht i njejtë ka qene i punesuar ne ate kompani derim ne muajin maj te vitit 2018,ndersa projekti eshte hartuar ne qershor te viti 2019.

Dhe nese keni lexuar me kujdes Njoftimin e fundit per refuzimin e tenderit tuaj pikerisht arsyeja kryesore per kete eshte Opinioni i AKK-se.

Shtojce:

-Opinioni i AKK-se;

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	10.06.2020	Nr. Prot. 03-03/1222/20
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-845/20	Data 11-06-2020
PËR/ZA/TO:	z. Zeke BARDHAJ, Menaxher i Zyrës së Prokurimit Komuna e Prishtinës	
CC:	z. Shpend AHMETI, Kryetar i Komunës së Prishtinës	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit	
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me kërkesën për konflikt të interesit në aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës"	

I nderuar z. Bardhaj,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, për konflikt të interesit në aktivitetin e prokurimit publik me titull: "Ndërtimi i Parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës", me numër të prokurimit: 616/19/7632/511, dhe me nr. të brendshëm: 616/19/173/511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ekziston konflikti i interesit në rastin e trajtuar me Nr. AKK- DPKPP /03-03-845/20, në aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës", me numër të prokurimit: 616/19/7632/511, dhe me nr. të brendshëm: 616/19/173/511, për arsye se punonjësi i OE "BENI COM" SH.P.K ka marr pjesë në hartimin e specifikave teknike respektivisht në hartimin e dokumentacionit investivo-teknik për Projektin "Renovimi i hapësirës tek Posta-Lagjja Dardani".

Kjo situatë bie ndesh me nenin 1. 75 të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, si dhe nenin 5. 4 dhe nenin 5.5 të Kodit Etik të Prokurimit.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), nga informacioni i pranuar për konflikt interesi në aktivitetin e prokurimit publik me titull: **"Ndërtimi i Parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës"**, me numër të prokurimit: 616/19/7632/511, dhe me nr. të brendshëm: 616/19/173/511, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, sipas kërkesës të datës 26 mars 2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03/845/20, me qëllim të analizimit, vlerësimit dhe konstatimit për konflikt interesi në aktivitetin e prokurimit të lartë cekur.

Raportuesi ne parashtresën e dt. 26 mars 2020, ka theksuar: Në aktivitetin e parë të prokurimit me nr. 616/18/5962/221, i cili ka qenë i ndarë dhe i pavarur nga aktiviteti i dytë i prokurimit që AK-së Komuna e Prishtinës ka shpallur ka ofertuar OE "RIMI ENG" SH.P.K. (në bashkëpunim me operator tjetër). Në këtë aktivitet të prokurimit ka qenë si pjesë e stafit të këtyre operatorëve ekonomik edhe një person i cili është punonjës i OE "BENI COM". Ndërsa OE "BENI COM" nuk ka qenë fare pjesëmarrës në këtë aktivitet. Në aktivitetin e dytë me nr. 616/19/7632/511, i cili po ashtu ka qenë në periudhë dhe në tërësi i pavarur nga aktiviteti i parë i prokurimit, që AK-së Komuna e Prishtinës e ka shpallur, ku ka ofertuar OE "BENI COM", punonjësi që ka qenë aktiv ne tenderin tjetër dhe nuk e ka angazhuar fare në këtë ekzekutim të punimeve. Pra në këtë aktivitet të prokurimit, për kundër kërkesave të autoritetit kontraktues inxhinier ne fjalë nuk e ka angazhuar si punonjës të vetin. Operatori ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit ka angazhuar inxhinier tjetër, dhe të njëjtin nuk e ka angazhuar as si menaxher të punimeve dhe as punëtor ndihmës, thjesht është punonjës në "BENI COM", por jo edhe për këtë aktivitet të prokurimit.

- A mundet të eliminohet nga tenderi si shkak i konfliktit të interesit OE "BENI COM", i cili ka të punësuar një inxhinier që ka marrë pjesë në aktivitetin e parë, për deri sa OE "BENI COM", këtë inxhinier nuk e ka angazhuar as si staf profesional as staf ndihmës në këtë tender.
- Pse duhet të quhet konflikt interesi kur OE këtë punonjës i cili ka marrë pjesë në aktivitetin e parë të prokurimit me një operatorë tjetër ekonomik, nuk e ka prezantuar fare si staf profesional dhe as staf ndihmës në këtë tenderim.
- A duhet të quhet konflikt interesi kur operatori ekonomik këtë inxhinier nuk e ka paraqitur si menaxher të punimeve dhe as pjesë të stafit ndihmës në këtë tenderim.

Pas analizimit të informatës, dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit dhe dokumenteve ta ofruar nga AK Komuna e Prishtinës, Agjencia konstaton:

Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës dhe Grupi i OE "RIMI ENG" SH.P.K. & "ENGGROUP" SH.P.K. Prishtinë, me datë 26 tetor 2018, ka nënshkruar kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve për objekte, plotësimi i objekteve për projekte dhe shqyrtimi i konstruksionit nga aspekti i stabilitetit dhe funksionalitetit", me numër të prokurimit: 616/18/094/221, e cila kontratë është nënshkruar nga z. Safet Lipovica- Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë, për fazën Hidro – Instalimet. Po ashtu, i njëjti i inxhinier me vendim është caktuar në stafin për hartimin e dokumentacionit investivo-teknik për Projektin "Renovimi i hapësirës tek Posta-Lagjja Dardani", në fazën e statikes .

Në bazë të Listës së pagave për kompanitë, të nxjerr në ATK, për vitin 2016, 2017, 2018 dhe 2019, rezulton se z. Lipovica është punonjës i OE "BENI COM" SH.P.K..

Pas administrimit të provave të marruar nga sistemi elektronik i prokurimit dhe dokumentacionit të ofruar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se në situatën e tillë kemi të bëjmë me konflikt të interesit, për faktin se punonjësi i OE "BENI COM" SH.P.K ka marr pjesë në hartimin e specifikave teknike respektivisht në hartimin e dokumentacionit investivo-teknik për Projektin "Renovimi i hapësirës tek Posta-Lagjja Dardani" (po ashtu ka nënshkruar kontratën me dt. 26 tetor 2018) , dhe njëkohësisht është punëtor i rregullt tek OE "BENI COM" SH.P.K., ku neni 5. 4 dhe neni 5.5 të Kodit Etik të Prokurimit në mënyrë të detajuar rregullon kur mund të lindë konflikti i interesit në një procedurë të prokurimit publik.

SOVEREIGN
AGENCY
KORUPSION
PUBLIC

Në nenin 1.75 i Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, **Konfliktet e interesit**, shprehimisht thuhet: "çdo situatë ku anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit".

Në nenin 5.4 të Kodit Etik të Prokurimit shprehimisht thuhet: Janë tri pika të caktuara të një procedure të prokurimit publik, ku mund të lind konflikti i interesit:

- brenda autoritetit kontraktues
- ndërmjet autoritetit kontraktues dhe tenderuesit
- mes atij që ka përgatitur specifikimet teknike/dokumentet e tjera mbështetëse dhe tenderuesit.

Për qëllime të kësaj deklarate, individi konsiderohet se ka konflikt interesi kur individi, ose ndonjë anëtar familjeje ose bashkëpunëtor i tij:

- a) Ka një interes aktual ose potencial financiar ose të llojit tjetër i cili dëmton ose mund të dëmtojë pavarësinë e gjyqimit të individit gjatë kryerjes së detyrave ndaj organizatës, ose
- b) Mund të ketë ndonjë përfitim material financiar ose tjetër, nga posedimi i informacionit i cili është i natyrës konfidenciale. "Familja" e individit përfshin gruan, prindërit, vëllezërit dhe motrat, fëmijët dhe të afërmit tjerë.

Po ashtu në nenin 5.5 të Kodit Etik të Prokurimit shprehimisht thuhet: "Bashkëpunëtor" i individit konsiderohet çdo person, organizatë ose ndërmarrje në të cilën ose me të cilën individi ose ndonjë anëtar i familjes së tij/saj është:

- a) Drejtor, zyrtar, punëtor, anëtar, partner, ose dorëzanë;
- b) Ka ndonjë interes financiar që ia mundëson atij të veprojë i vetmuar ose në bashkëpunim me të tjerët për të ushtruar kontroll ose ndikim të madh mbi politikën;
- c) Ka ndonjë lidhshmëri tjetër materiale.

Me respekt !

UVA KUSOVO